



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Komuna Podujevë shpall:

## Konkurs

### Lëvizje brenda kategorisë

*Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.*

<b>Titulli i pozitës së punës</b>	Zyrtar për Zhvillim
<b>Klasa e pozitës</b>	Profesional 2
<b>Koeficienti/Paga</b>	7
<b>Nr. i kërkuar</b>	1
<b>Data e njoftimit</b>	18/07/2022
<b>Afati për aplikim</b>	02/08/2022 - 09/08/2022
<b>Institucioni</b>	Komuna Podujevë
<b>Departamenti</b>	Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik
<b>Divizioni</b>	
<b>Vendi i punës</b>	Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00009466
<b>Kodi</b>	RPC0003204



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

- Grumbullimi, përpunimi dhe hartimi i projekteve;
- Mbikëqyrja dhe realizimi i projekteve;
- Evidentimi dhe arkivimi i projekteve të dorëzuara dhe të realizuara;
- Ofrimi i këshillave rreth projekteve;
- Përcjellja e të arriturave bashkëkohore në këtë fushë;
- Bashkëpunon me Drejtoritë relevante, donatorët agjencionet e specializuara dhe nivelin qendror;
- Përgatitë platformën e PIP-it, e plotëson dhe rifreskon sipas nevojës dhe limiteve buxhetore;
- Identifikon opsionet për projektet e mëdha apo të vogla;
- Siguron që rreziqet e projektit janë të zbatuara dhe të identifikuar;
- Vlerëson opsionet e rekomanduara, vlerësimet e kostove fillestare dhe outputet;
- Përshkruan rezultatet e projektit;
- Përgatitë raporte periodike për realizimin e projekt propozimeve në gjithë sektorët;
- Kujdeset për aftësimin e vazhdueshëm profesional;
- Kryen edhe punë që i cakton udhëheqësi i sektorit dhe drejtori i Drejtorisë.

## 2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

---

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.





## 9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Intervist

## 10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Mënyra e aplikimit

---

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

